

Prindërve të nxënësve,
të cilët konsiderohen se janë persona të kontaktit
të drejtpërdrejtë.

Informacion i dobishëm për personat e kontaktit dhe rregulloret e karantinës për prindërit, fëmijë e të cilit kanë kontakt të drejtpërdrejtë me dikë, që është testuar dhe ka rezultuar pozitiv me SARS-COV-2.

Të dashur prindër të personave të kontaktit,

Pandemia me virusin e coronës kërkon në masë të madhe fleksibilitet dhe bashkëpunim nga të gjithë qytetarët. Përvojat e javëve të fundit kanë treguar, që pyetjet e përsëritura lindin kur ka një person, i cili ka rezultuar pozitiv me SARS-CoV-2.

Ju po i merrni këto informacione, sepse femiu i juaj aktualisht është kontakt i drejtpërdrejtë i një personi të infektuar dhe për këtë arsye është nën karantinë. Kjo është përcaktuar nga departamenti i shëndetësisë dhe informata u është kumtuar gojarisht nga menaxhmenti i shkollës dhe kujdestar-ja i/e klasës. Njoftimi me **shkrim nga departamenti i shëndetësisë për karantinë** do të ju dërgohet me post.

Karantinë do të thotë, që femiu juaj do të qëndroj në shtëpi dhe të mos largohet nga shtëpia deri në datën e caktuar dhe nëse është e mundur të ndahet nga antarët e tjerë të familjes. Tek fëmijët e vegjël ideale do të ishte, që kjo të bëhej nën përcjelljen e prindit apo personit kujdestar.

Informacioni mbi kujdesin për fëmijët në karantinë dhe humbjet e fitimeve, që lidhen me karantinën mund ti gjeni në faqen e internetit Landschaftsverband Westfalen-Lippe (LWL)
https://www.lwl.org/pressemitteilungen/nr_mitteilung.php?urlID=50644

Informacione të përgjithshme mbi karantinën në shtëpi i gjeni në faqen e internetit të Institutit Robert Koch https://www.rki.de/DE/Content/InfAZ/N/Neuartiges_Coronavirus/Quarantaene/Inhalt.html

Mbani një ditar shëndetsor për fëmion tuaj gjatë karantinës. Vëzhgoni dhe bëni pyetje në lidhje e simptoma të tilla si simptoma të ftohjes, diarres ose dhimbjes së kokës. Përveç kësaj, ju lutem kontrolloni temperaturë dy here në ditë, në mëngjes dhe në mbrëmje, mundësisht në të njëjtën kohë dhe shënoni vlerat.

Nëse vëreni ndonjë shenjë të sëmundjes, na kontaktoni menjëherë dhe jepni **emrin e femiut, datën e lindjes, adresën, numrin e telefonit dhe natyrën dhe masën e ankesës si dhe shkollën dhe klasën.** Ju

lutem t'i dërgoni keto informacione në kutinë postare testanfrage@kreis-lippe.de në departamentin e shëndetësisë.

Ne do të organizojmë një test bazuar ne ankesat e femiut tuaj, koleget nga qendra e testimeve lajmerohen tek ju, meqense femiu juaj gjatë kesaj kohe gjendet tashmë në karantinë, ju mbetët juve , të kujdeseni,që femiu juaj të shkoj direkt në vendin e dakorduar dhe më pas në rrugën më të shkurtër të kthehet direkt në shtëpi, pa u ndalur askund.

Pikat e mëposhtme duhet të respektohen për tëstim:

- Ju lutem të arrini të sakt në orarin e caktuar , përmabjuni rregullave të distances, për të shmangur mledhjen në grupe të mëdha.
- Mos shkoni këmbë dhe mos përdorni mjete publike te transportit
- Nëse nuk und të përdorni automjet personal, ju lutem na informoni.
- Gjatë udhëtimit të gjithë personat mbajnë mjete mbrojtëse për gojë dhe hundë (me pëjashtim të drejtuesit të automjetit). Maska hiqet vetem shkurt gjatë marrjes së strishës.
- Një orë para marrjes së strishës nuk lejohet përdorimi I ushqimit dhe i pijeve, gjithashtu përtypja e çamçakëve, bonbonave dhe thithja e duhanit.
- Të miturit vijnë në përcjellje të prindit apo personit kujdestar ligjor, ose të njëjtit japin pëlqimin me nënshkrim për marrjen e strishës
- Nëse provat mirren në qendrën e testimeve, atëhere nuk keni nevojë të zbrisni nga vetura.

Mundësia për të refuzuar marrjen e strishës nuk ekziston sipas § 25 paragrafi 3 I aktit të mbrojtjes nga infeksionet, atëherë jeni të detyruar të lejoni marrjen e strishës.

Rezultatet e provave pozitive ju kumtohen përmes telefonit nga ana e departamentit të shëndetsisë. Rezultatet negative nuk mund të kumtohen në telefon për arsye të kapacitetit. Mundësi alternative për të pranuar rezultatin ju jepen gjatë marrjes së provave.

Edhe nëse rezultati I testit është negative, karantina duhet të vazhdoj deri në datën e përcaktuar në çertifikatë. Si masë paraprake, ne do të deshironim të theksonim, që shkeljet e karantinës mund të gjobitën nga zyra e rendit publik.

Familjarët ose antarët e familjes, të cilët kosiderohen të jenë person i kontaktit të përsoneit të kontaktit shpesh janë shumë të pasigurtë, se si të sillen në detaje, por patjeter rekomandohet, që të ndaheni nga personi në karantinë, I cili duhet të ndahet vazhdimisht nga pjesa tjetër e familjes (me fëmijë më të vegjel në mënyrë ideale me një prind).

Në thelb, personat e kontaktit të personave të kontaktit nuk janë testuar dhe mund të vazhdojnë punën e tyre pa kufizime, derisa merret rezultati i proves se personit të prekur të kontaktit të drejtpërdrejtë. Kjo vlenë edhe për njerëzit që punojnë në profesione të rëndësishme sistematikisht ose fusha të ndjeshme të veprimtarisë. Marrëveshjet, që ndryshojnë nga kjo mund diskutohen me punëdhënësin dhe nuk janë përgjegjësi e departamentit të shëndetësisë.

Me këtë informacion shpresojmë t'u jemi përgjigjur paraprakisht disa prej pyetjeve tuaja.

Kaloni pandeminë në mënyrë të sigurtë dhe qëndroni të shëndetshëm!

Departamenti juaj shëndetsor